

Vendim nr. 110 datë 20.05.2024

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Elsa Toska, Sandër Beci, Genti Ibrahim, Marjana Semini, Sonila Bejtja, anëtarë, në datën 20.05.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 3 (N) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: NEIM KADËNA, përfaqësuar nga avokate Fjoralba Prifti, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-4167 (625), datë 25.10.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 5, 7, 15, pika 2, 17, 33, 42, 43, 116, 122, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, 135, 142 dhe 145 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 1, 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 49, pika 3, shkronja “e”, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Neim Kadëna është i biri i shtetasit T.K., i cili është një nga trashëgimtarët ligjorë të shtetasit N.K. Me vendimin nr. 1553, datë 09.09.1993, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë,

ka vendosur njohjen e pronësisë të trashëgimtarëve ligjorë të shtetases N.K. për një truall me sipërfaqe 3000 m² të ndodhur në zonën “Uji i Ftohtë”, Vlorë. Më tej, trashëgimtarët ligjorë të N.K. i janë drejtuar Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP) Vlorë, për njohje dhe kthim të truallit me sipërfaqe 3000 m².

2. Ndërkohë, për truallin me sipërfaqe 3000 m² të ndodhur në zonën “Uji i Ftohtë”, Vlorë, me vendimin nr. 59, datë 21.11.1994 të KKKP-së Vlorë, u është njohur pronësia familjeve Anastasiadhi, Muzina, Peshkëpia dhe Toptani.

3. Me vendimin tjetër me të njëjtat ekstremite nr. 59, datë 21.11.1994 (*vendimi nr. 59/1994*), KKKP-ja Vlorë ka vendosur rrëzimin e kërkesës së trashëgimtarëve të N.K., duke mos i njohur ata ish-pronarë të truallit me sipërfaqe 2048 m² të ndodhur në zonën “Uji i Ftohtë” Vlorë, pasi rezulton se, sipas vërtetimit të kadastrës, shtetasi T.K. (i biri i trashëgimlënësës N.K), nuk ka qenë pronar, por ky truall i është dhënë për ekonomi ndihmëse, konform ligjit nr.108, datë 29.08.1948 “Për reformën agrare” dhe është regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme të viteve 1950-1952.

4. Me vendimin nr. 59/1994, KKKP-ja, Vlorë ka vendosur rrëzimin e kërkesës së trashëgimtarëve të N.K., duke mos i njohur si ish-pronarë të truallit me sipërfaqe 3000 m², të ndodhur në zonën “Uji i Ftohtë”, Vlorë, pasi pronësia u është njohur familjeve Anastasiadhi, Muzina, Peshkëpia dhe Toptani.

5. Shtetasi T.K. i është drejtuar gjykatës me padi për kundërshtimin e vendimit nr. 59/1994 të KKKP-së, Vlorë dhe njohjen pronar të truallit me sipërfaqe 3000 m², të ndodhur në zonën “Uji i Ftohtë”, Vlorë. Gjykata ka bashkuar këtë padi me padinë e shtetasve R.F. dhe H.Ç., të cilët kanë pretenduar anulimin e vendimit nr. 59/1994 të KKKP-së, Vlorë dhe njohjen pronarë të truallit me sipërfaqe 40.000 m², të ndodhur në zonën “Uji i Ftohtë”, Vlorë.

6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 2360, datë 25.09.1995, ka vendosur pranimin e padisë, duke e njohur paditësin T.K. pronar të truallit me sipërfaqe 3000 m², të ndodhur në zonën “Uji i Ftohtë”, Vlorë dhe rrëzimin e pretendimeve të paditësve R.F. dhe H.Ç. Ky vendim është ankimuar nga paditësit R.F. dhe H.Ç. në gjykatën e apelit.

7. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 74, datë 12.01.1996, ka lënë në fuqi vendimin nr. 2360, datë 25.09.1995 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Kundër këtij vendimi paditësit R.F. dhe H.Ç. kanë bërë rekurs në Gjykatën e Lartë.

8. Kolegji Civil i Gjykatës së Kasacionit, me vendimin nr. 963, datë 14.06.1996, ka vendosur prishjen e vendimeve nr. 2360, datë 25.09.1995 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe nr. 74, datë 12.01.1996 të Gjykatës së Apelit Vlorë, si dhe kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

9. Në rigjykim Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 182, datë 11.02.1998, ka vendosur njohjen pronar të shtetasit T.K. për truallin me sipërfaqe 3000 m², të ndodhur në zonën “Uji i Ftohtë”, Vlorë. Ky vendim ka marrë formë të prerë dhe është regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP), Vlorë.

10. Po kështu, rezulton se trashëgimtarët e familjes Kadëna i janë drejtuar gjykatës për kundërshtimin e vendimit nr. 59/1994 të KKKP-së, Vlorë, për pjesën që nuk u është njohur pronësia për truallin me sipërfaqe 2048 m². Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 245, datë 07.02.1996, ka vendosur shfuqizimin e vendimit nr. 59/1994 të KKKP-së, Vlorë dhe njohjen e pronësisë për truallin me sipërfaqe 2048 m² për paditësit, pjesëtarë të familjes Kadëna. Ky vendim ka marrë formë të prerë.

11. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 245, datë 07.02.1996, ka vendosur vetëm njohjen e pronësisë, por jo kthimin fizik të saj, ndaj kërkuesi Naim Kadëna, në cilësinë e trashëgimtarit ligjor të N.K., i është drejtuar KKKP-së, Vlorë për njohjen e së drejtës së pronësisë dhe kthimin fizik të truallit me sipërfaqe 2048 m², të ndodhur në zonën “Uji i Ftohtë”, Vlorë. Me vendimin nr. 99, datë 30.04.1996 (*vendimi nr. 99/1996*), KKKP-ja, Vlorë ka vendosur njohjen e pronësisë dhe kthimin fizik të truallit me sipërfaqe 2048 m² trashëgimtarëve Kadëna.

12. Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare (DSHQ) i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me padi me objekt prishjen e vendimit nr. 99/1996 të KKKP-së, Vlorë dhe njohjen pronar të një trualli me sipërfaqe 2048 m² (3000 m²).

13. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 450, datë 02.04.2001, ka vendosur rrëzimin e padisë së DSHQ-së si të pabazuar në ligj e në prova. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. 431, datë 05.10.2001 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe me vendimin nr. 429, datë 24.02.2003, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga DSHQ-ja.

14. Në vijim, me VKM-në nr. 1058, datë 16.07.2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në përgjegjësi administrimi Këshillit të Ministrave, për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare” (VKM nr. 1058/2008), është miratuar lista e

inventarit të pronave pasuri të paluajtshme shtetërore, të cilat kalonin në administrim të DSHQ-së. Në numrin rendor 17 përshkruhej kalimi në administrim edhe i një sipërfaqeje trualli prej 150.000 m² në zonën “Uji i Ftohtë”, Vlorë, si dhe i vilave 1, 2, 6 e 9. Bazuar në këtë VKM, Garda e Republikës ka rrethuar sipërfaqen prej 2048 m² të kthyer trashëgimtarëve të N.K. me vendimin nr. 99/1996 të KKKP-së, Vlorë.

15. Kërkuesi dhe trashëgimtarët e tjerë të familjes Kadëna i janë drejtuar gjykatës me padi me objekt rivendosjen në posedim të sipërfaqes prej 2048 m², duke thirrur në gjykim, në cilësinë e palës së paditur, DSHQ-në. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 660, datë 24.03.2010, ka vendosur pranimin e padisë dhe rivendosjen e paditësve në posedim të sipërfaqes 2048 m². Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. 733, datë 15.07.2010 të Gjykatës së Apelit Vlorë, kurse Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, i vënë në lëvizje me rekursin e palës së paditur, me vendimin nr. 1478, datë 06.10.2011, ka vendosur mospranimin e rekursit.

16. Në datën 08.02.2012 DSHQ-ja i është drejtuar gjykatës me padi, me objekt njohjen si pronare të ligjshme për pasuritë e paluajtshme tokë truall me sipërfaqe 2048 m² dhe 3000 m², me palë të paditur trashëgimtarët e familjes Kadëna. Sipas paditëses, pasuria e poseduar nga familja Kadëna është pasuri publike e përfshirë në territorin ku ndodhet rezidenca qeveritare në zonën “Uji i Ftohtë”, Vlorë, referuar VKM-së nr. 1058/2008, për rrjedhojë ka kërkuar njohjen si pronare të ligjshme për pasuritë tokë truall me sipërfaqe 2048 m² dhe 3000 m², si dhe pavlefshmërinë absolute të vendimit nr. 99/1996 të KKKP-së, Vlorë.

17. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 1700, datë 27.06.2013, ka vendosur rrëzimin e padisë, duke arsyetuar se pala paditëse nuk ka arritur të provojë kushtin themelor të padisë së rivendikimit, të qenurin pronare për pasurinë objekt gjykimi. Kundër këtij vendimit ka paraqitur ankim pala paditëse, DSHQ-ja.

18. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 1375, datë 18.09.2014, ka lënë në fuqi vendimin nr. 1700, datë 27.06.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, duke e vlerësuar të drejtë dhe të bazuar në ligjin procedural e material. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs pala paditëse.

19. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-4167(625), datë 25.10.2023, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 1375, datë 18.09.2014 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me tjetër trup gjykues. Sipas Gjykatës së Lartë, moskryerja e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm

të çështjes, mosdhënia përgjigje për çështjet faktike dhe të ligjit të pretenduara nga pala paditëse në gjykim, mospërcaktimi i saktë i objektit të kërimit në këtë gjykim në lidhje me individualizimin e qartë të sipërfaqeve objekt rivendikimi (2048 m² dhe 3000 m²), moskryerja e një akti ekspertimi dhe mungesa e një analize tekniko-topografike për identifikimin e saktë të pasurive të pretenduara nga pala paditëse dhe pasurive të trajtuara në favor të palëve të paditura, për të përcaktuar nëse janë e njëjta pasuri apo pasuri të ndryshme nga njëra-tjetra, e ka bërë zgjidhjen e kësaj çështjeje nga dy gjykatat më të ulëta të paqëndrueshme dhe të pambështetur në ligj dhe prova. Për rrjedhojë, sipas asaj gjykate, me sqarimin e kësaj çështjeje mund të konkludohet se cila pjesë e kërimit përbën gjë të gjykuar dhe cila kërkon shqyrtim më të thelluar, duke u dhënë përgjigje të argumentuar pretendimeve të palëve ndërgjyqëse.

20. Në datën 26.02.2024, përmes shërbimit postar, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 21.03.2024. Në vijim, në datën 26.04.2024, kërkuesi ka paraqitur kërkesë për plotësim të ankimit kushtetues. Kolegji i Gjykatës, bazuar në nenin 31, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, në datën 17.04.2024 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve.

II

Pretendimet e kërkuetit

21. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

21.1. *Parimit të sigurisë juridike në drejtim të gjësë së gjykuar (res judicata)*, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk ka marrë në konsideratë pretendimin e kërkuetit se çështja përbënte gjë të gjykuar sipas ligjit. Gjykatat e ulëta kanë arsyetuar se çështja përbën gjë të gjykuar, pasi nga provat e marra në shqyrtim Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 450, datë 02.04.2001, ka rrëzuar padinë e DSHQ-së për kundërshtimin e vendimit nr. 99/1996 të KKKP-së, Vlorë dhe njohjen e saj pronare të një trualli me sipërfaqe 2048 m² (3000 m²), vendim që është lënë në fuqi nga gjykatat më të larta. Pavarësisht mënyrës së formulimit të padisë, në atë gjykim themeli i pretendimeve dhe i së drejtës së kërkuar, në thelb, është i njëjtë me atë të padisë në çështjen objekt gjykimi. Gjykimi është zhvilluar mes të njëjtave palë dhe

ka pasur të njëjtin objekt, detyrimin e të paditurve Kadëna të njohin pronar DSHQ-në dhe kundërshtimin e pronësisë së tyre. Parimi i sigurisë juridike është cenuar edhe për sa i përket truallit me sipërfaqe 3000 m², i fituar nga trashëgimtarët Kadëna me vendimin nr. 182, datë 11.02.1998 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, i cili ka marrë formë të prerë. Nëse ai vendim ka cenuar interesat e shtetit, mjetei i vetëm është kërkesa për rishikim, sipas nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile (KPC) dhe jo padia e rivendikimit e ngritur nga Avokatura e Shtetit, çka as nuk është në funksionet e saj sipas nenit 5 të ligjit nr. 10018/2008 “Për Avokaturën e Shtetit”. Legjitimimi i DSHQ-së dhe Avokaturës së Shtetit për ngritjen e padisë është tregues tjetër i shkeljes të së drejtës për proces të rregullt ligjor.

21.2. *Parimit të barazisë përpara ligjit*, pasi në paragrafin 24.1 të vendimit të kundërshtuar të Gjykatës së Lartë arsyetohet, ndër të tjera, se për pasuritë publike nuk mund të ndiqen të njëjtat rregulla tjetërsimi, fitimi pronësie ose mbrojtjeje pronësie sikurse veprohet me pronat jopublike të shtetit. Ky arsyetim është në kundërshtim edhe me përmbajtjen e nenit 5 të ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, i cili nuk ka fuqi prapavepruese.

III

Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

A. *Për legjitimimin e kërkuarit*

22. Çështja e legjitimitit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhen me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të verë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

23. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Këto kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato

duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej këtyre kritereve që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

24. Në rastin në shqyrtim kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor të kundërshtuar, ndaj ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e paraqitur.

25. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese që pretendohet se janë cenuar. Ky kriter kërkon shfrytëzimin në rrugë normale të mjeteve juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve juridike efektive ka të bëjë me kontrollin subsidiar që ushtron Gjykata, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit (*shih vendimin nr. 56, datë 25.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion subsidiar, kjo do të thotë se mund të kërkohet vetëm për një vendim gjyqësor përfundimtar që përmbyll procesin gjyqësor (*shih vendimin nr. 48, datë 06.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Në të njëjtën linjë, neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000 përcakton se mjetet juridike efektive duhet të shterohen nga kërkuesi përpara se ai t’i drejtohet Gjykatës. Sipas kësaj dispozite përmbushja e këtij kriteri është detajuar në dy hipoteza: i) kur kërkuesi ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive para se t’i drejtohet Gjykatës; ii) kur legjislacioni i brendshëm nuk parashikon mjete efektive në dispozicion. Për rrjedhojë, kërkuesi duhet të vërtetojë se përpara se t’i drejtohet Gjykatës ai ka përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura (*shih vendimet nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës për kundërshtimin e vendimit nr. 00-2023-4167 (625), datë 25.10.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë që ka vendosur prishjen e vendimit nr. 1375, datë 18.09.2014 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me tjetër trup gjykues.

28. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se vendimet e këtij lloji, për më tepër kur procesi i themelit vazhdon të jetë në gjykim, nuk mund të konsiderohen si përfundimtare, për

efektet e gjykimit kushtetues, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, pasi ato nuk vendosin në mënyrë përfundimtare për themelin e çështjes. Në të tilla raste kërkuesi i ka të gjitha mjetet e nevojshme juridike për mbrojtjen e interesave të tij gjatë rigjykimit të çështjes, përfshirë më pas edhe mbrojtjen kushtetuese në këtë Gjykatë (*shih vendimet nr. 39, datë 06.07.2016; nr. 48, datë 06.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, përjashtimisht nga rregulli i parashikuar në nenin 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, kontrollit kushtetues mund t’i nënshtrohen edhe vendime të tilla, me natyrë jo përfundimtare, që jepen gjatë një procesi gjyqësor, nëse plotësohen disa kritere që lidhen me pasojat e drejtpërdrejta ndaj së drejtës kushtetuese të individit (*shih vendimin nr. 59, datë 14.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Në kuptim të sa më sipër, Mbledhja e Gjyqtarëve duhet të vlerësojë nëse në rastin konkret shkelja e pretenduar nga kërkuesi, për nga natyra e saj, është e tillë që as ajo, as pasojat e saj nuk mund të riparohen gjatë rigjykimit të çështjes, pra në procesin gjyqësor që është duke u zhvilluar në gjykatat e juridiksionit e zakonshëm, pra nëse kërkuesi ka në dispozicion mjete ligjore efektive për të kërkuar mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të pretenduara të cenuara.

30. Në rastin konkret, Gjykata e Lartë ka disponuar kthimin e çështjes për rishqyrtim nga gjykata e apelit, bazuar në orientimet e dhëna nga ajo gjykatë, pasi procesi i themelit ende nuk ka përfunduar. Gjykata e Lartë nuk ka dhënë një përgjigje përfundimtare për zgjidhjen në themel të mosmarrëveshjes, pasi ka konstatuar se qëndrimi i mbajtur nga dy gjykatat e faktit, se ndodhen përpara rastit të gjësë së gjykuar, është rrjedhojë e moskryerjes së një hetimi të plotë e të gjithanshëm të çështjes, referuar edhe mospërcaktimit të saktë të objektit të kërkimit në atë gjykim në lidhje me individualizimin e qartë të sipërfaqeve objekt rivendikimi. Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se sipas Gjykatës së Lartë hetimi gjyqësor kishte mangësi, për rrjedhojë ajo nuk mund të vendoste nëse ndodhej apo jo para gjësë së gjykuar, çka kërkonte një hetim të plotë të çështjes në themel.

31. Mbështetur në standardet e mësipërme kushtetuese dhe referuar rrethanave të rastit në shqyrtim, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se pretendimet e parashtruara nga kërkuesi, për nga natyra e tyre, janë të tilla që duhet të shqyrtohen dhe sqarohen gjatë rigjykimit të çështjes, pra në procesin gjyqësor që është duke u zhvilluar në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, për rrjedhojë duhet të marrin përgjigje nga ato gjykata në ushtrim të juridiksionit të tyre. Në kushtet kur çështja është kthyer për rigjykim në gjykatën e apelit dhe procedurat gjyqësore për shqyrtimin e saj nuk kanë përfunduar ende, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se kërkuesi ka ende mjete ligjore efektive në

dispozicion për të mbrojtur të drejtat e tij kushtetuese të pretenduara si të cenuara, përfshirë më pas edhe mbrojtjen kushtetuese në këtë Gjykatë.

32. Për sa më lart, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se vendimi objekt i ankimit kushtetues individual nuk ka vendosur në mënyrë përfundimtare për çështjen gjyqësore, prandaj kërkuesi nuk legjitimohet për të vënë në lëvizje këtë gjykim kushtetues.

33. Në përfundim, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.¹

PËR KËTO ARSYE,

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

¹ Gjyqtari Genti Ibrahim i votoi për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, me arsyetimin se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të sigurisë juridike, si rezultat i mosrespektimit nga Gjykata e Lartë të vendimit gjyqësor që përbën gjë të gjykuar, nuk është haptazi i pabazuar.